

Edukimi STEM; Përfitimet, mundësitë, sfidat dhe mësimet për brezat e rinj

Anila PAPANISTO, Prill 2022

“Milionat e kishin parë rënien e mollës, por vetëm Njutoni pyeti pse!”

Si pjesë integrale e një shoqërie komplekse çdo njëri prej nesh duhet të marrë cdo ditë vendime që ndikojnë në jetën tonë të përditshme!

Shumë nga këto vendime lidhen drejtpërdrejt me sistemin arsimor, Ku do mësojmë? Për çfarë do mësojmë? A mund të kemi një shkollë që na mëson për të qenë të suksesshëm nesër?

Në ditët tona sistemi arsimor duket se po ndryshon vazhdimisht duke ndjekur zhvillimet teknologjike dhe duke ofruar mundësi të reja për zhvillimin e mësimet dhe të mësuarit, që shpesh janë të vështira për t'u kapur e përdorur nga të gjithë.

Këto ndryshime na kanë drejtuar drejt nevojës për të krijuar një shkollë ku nxënësit kanë nevojë të zgjedhin e vendosin përtej kurrikulave klasike ku lëndët ndahen mprehtë nga njëra-tjetra. Shpesh nxënësit sot duhet të kombinojnë lëndë të ndryshme akademike në procesin e tyre mësimor, pasi vetëm kështu ata mund të prodhojnë njohuri të qëndrueshme dhe ndërtojnë aftësi të nevojshme, të cilat rrisin shancet e tyre të suksesit nesër në tregun e punës.

Por a jemi plotësisht të përgatitur për këto ndryshime?

A u jep shkolla jonë nxënësve mjetet, njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t'u përballur suksesshëm me një treg pune që rend drejt një të nesërme shumë më të ndryshme nga e sotmja! Me një treg pune që riformatohet vazhdueshëm duke u liruar nga shumë profesione të vjetra me të cilat kemi bashkëjetuar prej kohësh!

A është edukimi që u japim brezave të rinj i përshtatshëm e në përputhje me ndryshimet dixhitale dhe ato ekonomike me të cilat përballet shoqëria sot?

Në një vështrim të shkurtër mbi realitetin duket se JO! Dhe jo vetëm kaq, por duket se edhe profesionet që kanë të bëjnë me Shkencën, Matematikën, Inxhinierinë dhe Teknologjinë nuk duket se tërheqin shumë të rinj e kjo ndoshta për shkak të mungesës së të kuptuarit të mundësive që ofron kjo fushë, megjithëse perspektivat e karrierës dhe zhvillimi i këtij tregu pune po lulëzojnë vazhdimisht.

Shumica e të rinjve sot luftojnë për të kuptuar rëndësinë e shkencës, sepse ata gjatë mësimet të shkencës duket se nuk shohin dot lidhjen midis asaj që mësojnë në klasë dhe ngjarjeve të botës reale.

Gjithashtu shumica e të rinjve kanë një perceptim që lëndët shkencore janë ose shumë të vështira ose shumë të mërzitshme.

Në këto kushte lind natyrshëm pyejtja:

A është edukimi STEM zgjidhja?

STEM është një akronim për **Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë**.

Edukimi STEM i lidh këto disiplina në një sistem koheziv. Kështu, përgatit profesionistë, të cilët mund ta transformojnë shoqërinë me inovacione dhe zgjidhje të qëndrueshme.

Edukimi STEM është shumë i rëndësishëm për shoqërinë njerzore! Thelbi i tij është **krijimi i zgjidhësve të problemeve**, të cilët njohin dhe i kuptojnë shkaqet e egzistencës së problemeve dhe dinë të diferencojnë prej tyre pasojat duke e drejtuar shoqërinë njerzore drejt zgjidhjeve dhe vendimeve efektive.

Edukimi STEM **shkon përtej lëndëve shkollore**. Ai jep një grup aftësish që rregullojnë mënyrën se si mendojmë dhe sillemi.

Edukimi STEM synon të **aftësojë nxënësit për sfidat** me të cilat përballet shoqëria në ndryshim.

Edukimi STEAM **zhvillon kreativitetin**, bashkëpunimin, rrit angazhimin dhe motivimin si dhe personalizon përvojën e të mësuarit.

Edukimi STEM **zhvillon mendimin kritik**, zgjeron njohuritë shkencore dhe mundëson gjeneratën e ardhshme të novatorëve.

Edukimi STEM **nxit inovacionin dhe kuriozitetin**.

Edukimi STEM ndihmon në **mësimin e aftësive** të rëndësishme të jetës, veçanërisht **buxhetimin** dhe trajtimin e parave.

Edukimi STEM u **jep njerëzve aftësi** që i bëjnë ata më të punësueshëm dhe të gatshëm për të përmbushur **kërkesat aktuale të tregut të punës**.

Edukimi STEM **inkurajon nënësit të bëjnë pyetje**, të bëjnë supozime dhe të zhvillojnë aftësi që mund të përdoren gjatë gjithë jetës, ai **u përgjigjet pyetjeve** më të shpeshta të shoqërisë njerzore si ato që kanë të bëjnë me ngrohjen globale për të cilat sot 70% e të rinjve nga 18-34 vjeç janë të shqetësuar. Ai mund t'i mësojë ata se si të gjejnë zgjidhjet e nevojshme për një zhvillim të qëndrueshëm.


Edukimi STEM **angazhon të rinjtë të eksperimentojnë** me botën dhe elementët e saj.

Çdo degë e edukimit STEM thekson zhvillimin e aftësive specifike.

Mësimi i shkencës na ndihmon të kuptojnë më mirë mjedisin në të cilin jetojmë dhe na lejon të zhvillojmë aftësitë e të menduarit kritik.

Mësimi i aftësive të reja teknologjike na ndihmon të veprojmë në një botë që zhvillohet me ritme të shpejta dhe na zhvillon një kuptim të thellë të zhvillimit teknologjik.

Inxhinieria dhe matematika, na orientojnë drejt zgjidhjeve dhe na mësojnë se si të analizojmë situatat në mënyrë që të eliminojmë gabimet dhe të zgjidhin problemet në mënyrë më efikase.



***Duke inkurajuar të mësuarit STEM,
ushqehet kurioziteti, inovacioni
dhe kreativiteti!***

Punët STEM janë e ardhmja e ekonomisë sonë

Tregu i punës i shekullit të 21-të kërkon një grup të aftësish që kryesohen nga aftësitë teknologjike.

Punësimi në profesionet STEM parashikohet të rritet me 8.0% deri në vitin 2029, dhe profesionet e kujdesit shëndetësor, të cilat në përgjithësi kërkojnë një sfond të fortë STEM, parashikohet të rriten edhe më shumë. Ndërkohë, profesionet jo-STEM do të rriten vetëm 3.7%.

Në 2019 profesione STEM sipas Departamentit të Punës të Shteteve të Bashkuara fituan mesatarisht 86,980 dollarë në vit më shumë së dyfishin e profesioneve jo STEM.

STEM edukimi dhe barazia gjinore

Nga 1.8 milionë diploma bachelor të dhëna në 2015–16, rreth 331,000 (18 %) ishin në fushat STEM.

Përqindja e të diplomuarve (23 shkurt 2022), në STEM-Vendin kryesor e zë Gjermania, me 36,9% të të diplomuarve STEM.

Sipas Forumit Ekonomik Botëror, Kina ka numrin më të lartë të të diplomuarve në STEM në botë—të paktën 4.7 milionë në 2016. (Për krahasim, Shtetet e Bashkuara në vendin e tretë me 569,000)

Mes 50 milionë të diplomuarve të punësuar të moshës 25 deri në 64 vjeç në 2019, 37% raportuan një diplomë bachelor në shkencë ose inxhinieri, por vetëm 14% punonin në një profesion STEM, bazuar në vlerësimin 1-vjeçar të Byrosë së Regjistrimit të Komunitetit Amerikan 2019. , 2021

72% e studentëve të diplomuar në shkenca kompjuterike kanë një punë me kohë të plotë më pak se gjashtë muaj pas diplomimit.

Sipas raportit të UNESCO, 2017, në të gjithë botën, vetëm 30% e studentëve femra ndjekin studimet e arsimit të lartë të lidhur me STEM.

UNESCO (2017) e konsideron aksesin në arsimin STEM për vajzat si një e drejtë njerëzore.

Kompanitë me më shumë gra në bordet e tyre u zbuluan se ia kalonin rivalëve të tyre me një kthim më të lartë 42% në shitje, 66% kthim më të lartë në kapitalin e investuar dhe 53% kthim më të lartë nga kapitali.

Më pak se 50 përqind e prindërve thonë se vajza e tyre inkurajohet të ndjekë një karrierë STEM.